

Nr. 54 date 18. 03. 2002

PËR

FUNKSIONIMIN E SHËRBIMEVE TE POLICISË GJYQËSORE
NE POLICINË TATIMORE

Mbështetur ne nenin 17 te ligjit Nr.8677, date 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore":

1. Shërbimet e policisë gjyqësore ne rajonet e Policisë Tatimore ushtrojnë veprimtari procedurale sipas kompetencave lëndore dhe/ose tokësore e tyre brenda juridiksionit te prokurorive te ngriture pranë gjykatës se shkalles se pare
2. Shërbimet e policisë gjyqësore ne Drejtorinë e Policisë Tatimore ne Drejtorinë e Përgjithshme te Tatimeve ushtrojnë veprimtarinë e tyre procedurale ne te gjithë territorin e vendit, ne çdo rast brenda juridiksionit dhe nen drejtimin e prokurorisë kompetente.
3. Shërbimet e policisë gjyqësore gjate ushtrimit te veprimtarisë procedurale ruajnë hierarkinë qe kane ne ndërtimin administrativ te strukturave te Policisë Tatimore.
4. Drejtuesit e shërbimeve te policisë Gjyqësore ne Policinë Tatimore përgjigjen përpara prokuroreve qe drejtojnë hetimet për zbatimin e detyrave prej vartësve te tyre.
5. Me autorizim te prokurorit qe drejton hetimet drejtuesit e shërbimeve te policisë gjyqësore kontrollojnë realizimin dhe afatet e zbatimit te detyrave te urdhëruara dhe/ose te deleguara.
6. Drejtuesit e shërbimeve te policisë gjyqësore te gjitha niveleve u paraqesin menjëherë titullarëve te prokurorive kompetente listën emërore te oficerëve te

policisë gjyqësore që janë në vartësi të tyre duke përcaktuar rolin dhe profilizimin e secilit.

7 Drejtuesit e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë Tatimore njoftojnë 10 dite përpara drejtuesit e prokurorive kompetente në rastet kur transferohen oficeret e policisë gjyqësore për nevojën e punës.

8. Kur gjykohet bashkërisht se transferimet e oficerëve të policisë gjyqësore në Policinë Tatimore mund të sjellin pasoja në ecurinë e hetimeve vendoset pezullimi i përkohshëm i transferimeve deri në përfundim të hetimeve.

9. Oficeret dhe agjentët e shërbimeve gjyqësore në Policinë tatimore Realizojnë veprimtarinë e tyre procedurale me iniciativë, urdhrin apo delegim të prokurorit dhe mbajnë përgjegjësi për zbulimin, hetimin dhe dokumentimin në rrugë procedurale të veprave penale që do të delegohen.

10. Aktet procedurale të përpiluara nga oficeret dhe agjentët e policisë gjyqësore i referohen prokurorit kompetent, sipas mënyrës dhe kërkesave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Këto akte dërgohen menjëherë bashkëlidhur me shkresë të drejtuesit të shërbimeve të policisë gjyqësore ku janë kryer veprimet procedurale por jo më vonë se 24 orë nga momenti i marrjes së dëgjimit për veprën penale.

4. Gjate fazave të hetimeve paraprake, hetimi gjyqësor është deri sa gjykata jep vendim të formës së prapë oficeret e policisë gjyqësore që hetojnë apo kanë kryer hetimet përgjigjen para prokurorëve kompetentë për kryerjen me cilësi të detyrave që mund t'u ngarkohen në vazhdimësi.

5. Kur prokurori i çështjes dhe drejtuesi i shërbimit të policisë gjyqësore vlerësojnë të nevojshme. Oficerët policisë gjyqësore që kanë kryer marrin pjesë edhe gjate seancave të hetimit gjyqësor, për të ndihmuar prokurorin në paraqitjen e provave.

13 Për ecurinë e hetimeve dhe para marrjes së vendimeve për pushimin, pezullimin apo dërgimin për gjykim të procedimeve penale, prokurori kompetent organizon analizë, në të cilat raportojnë drejtuesit dhe oficeret e shërbimeve të Policisë gjyqësore që kanë bërë hetimin.

14 Në rastet kur në të njëjtat hetime janë përfshirë edhe oficerë të seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive, respektohen kërkesat e përcaktuara në pikat 11,12 dhe 13 të këtij udhëzimi.

15 Shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë Tatimore dhe seksionet e policive gjyqësore pranë prokurorive, çdo tre muaj shkëmbejnë informacione ndërmjet tyre për çështje që lidhen me:

- gjendjen e përgjithshme të kriminalitetit .
- tendencat më shqetësuese të tij
- marrjen e masave parandaluese